

VENDIM
Nr.309, datë 21.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.243, DATË 13.4.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR BULEVARDI “BAJRAM CURRI” DERI NË RRUGËN
“ALI DEMI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.243, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) në pikën 3 të vendimit, bëhen këto ndryshime:

- Sipërfaqja truall, nga 5 621 (pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e një) m², bëhet 5 612 (pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) m²;

- Vlera e përgjithshme, prej 167 668 810 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekësh, bëhet 167 400 348 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e katërqind mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë.

b) Në listën bashkëlidhur vendimit nr.243, datë 13.4.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet numri i pasurisë për bashkëpronarët Hyka, i cili, nga 8/542, bëhet 8/557.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kompensimi i pronarëve, për efekt shpronësimi, të fillojë më 15.4.2011 dhe të përfundojë më 15.7.2011.

4. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë bashkisë Tiranë.

5. Bashkia Tiranë të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga bashkia e Tiranës dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, bashkia e Tiranës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha